

**RAPORTI I AUDITUESES SE PAVARUR**

**PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2017**

**CFO PHARMA SHPK**

**NIPT K22305002U**

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

**Për Ortakun e Vetëm të shoqërisë “CFO PHARMA” shpk**

### **Opinionin me rezervë**

Une kam audituar pasqyrat financiare të bashkuara të shoqërisë “CFO PHARMA” shpk, (shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tim, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me rezervë në Raportin e Auditimit, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare të fluksit të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **Baza për opinionin me rezervë**

*1-Une u emerova si audituese e shoqërisë pas dates se bilancit dhe si rrjedhojë e kësaj nuk vezhgova inventarin fizik në fund të periudhës. Une nuk e kisha të mundur të bindem me procedurat e tjera alternative lidhur me sasitë gjendje të inventarit. Duke qenë se gjendja e inventarit ndikon në performancën financiare dhe të fluksit të parave, une nuk jam në gjendje të percaktoj nëse do të kishte nevojë të beheshin rregullime në fitimin e periudhës të raportuar në pasqyrën e të ardhurave dhe të fluksit të parave.*

*2-Referuar opinionit me rezerve të pasqyrave financiare të vitit paraardhës 2016 në lidhje me celjet e këtyre pasqyrave, qendron e njëjta rezerve për të cilën, une nuk mund të percaktoj me metoda të tjera alternative, nëse do të ishte e nevojshme të bëhej ndonjë rregullim si dhe nuk mund të percaktoj në mënyrë të arsyeshme me saktësi efektet që do të kishte sjellë ndonjë rregullim i mundshëm i tepërcave të mbylljeve të pasqyrave 2016 që shërbejnë si celje për pasqyrat financiare 2017.*



Une e kreu auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë e mia sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Une jam e pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kam përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Une besoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin me rezervë.

### **Çështjet Kryesore të Auditimit**

Çështjet Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tim profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tim në lidhje me to, kështu që për këto çështje une nuk jap një opinion të veçantë. Përveç çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë, une kam përcaktuar çështjet më poshtë si çështje kryesore të auditimit që duhet të komunikohen në raportin tim të auditimit.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare.**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat e mia janë që të arrij një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshoj një raport auditimi që përfshin opinionin tim. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësisë së audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në faqen e internetit të IEKA-s. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit të auditimit.

### **AUDITUESE E PAVARUR**

**Shpresa BREÇANI**



Date 01/04/2018

**AKTIVE****VITI 2017**  
**CFO PHARMA** **Bashkimi Viti 2016****Aktive afat gjate***Aktive afat gjate materiale**Te tjera aktive afat gjate* 1,355,732,029 783,098,002***Totali I Aktiveve Afatgjate*** 1,355,732,029 783,098,002**Aktive qarkulluese***Inventari* 407,623,578 872,101,274*Kliente (neto)* 816,567,263 593,028,873*Kerkesa te tjera te arketueshme(TVSH)* 5,921,048*Kerkesa te tjera te arketueshme(Tatim  
Fitimi)* - 1,579,279*Parapagime dhe shpenzime te shtyra* -*Likujditete* 14,656,587 46,563,191***Totali I Aktiveve Qarkulluese*** 1,244,768,477 1,513,272,617***Totali I Aktiveve*** 2,600,500,506 2,296,370,618.77**KAPITALET E VETA***Kapitali* 1,595,000,000 918,000,000*Kapitali qe I perket aksionereve te shoqerise  
meme(perdoret vetem ne PF te konsoliduara)**Rezerva te tjera* 15,024,936 15,024,936*Rezerva ligjore* 80,532,412 41,622,029*Rezerva rivleresimi**Fitim (humbje) të pa shperndara* 0 115,133,402*Fitim (humbje) e vitit ushtrimor* 118,757,283 57,756,098***TOTALI I KAPITALIT*** 1,809,314,631 1,147,536,465**DETYRIME****Detyrime afat gjate***Hua afat gjate* 355,804,613 153,048,692*Overdraft* 133,082,440***Totali I Detyrimeve Afatgjate*** 488,887,053 153,048,692**Detyrime afat shkurter***Llogari te pagueshme (furniture)* 206,363,815 837,096,602*Kesti afat shkurter i huase afat gjate****Detyrimet e Omega Pharma ndaj tatimeve*** 79,148,238 150,265,603*Te drejta dhe detyrime (dividenti)* 1,269,787 1,269,787*Te tjera detyrime afat shkurter ndaj**punonjesve dhe tatimoreve* 15,516,982 7,153,469*Provizionet afatshkurtra**Parapagimet e Arketuara****Totali I Detyrimeve Afatshkurtra*** 302,298,822 995,785,461***Totali I Detyrimeve*** 791,185,875 1,148,834,154***Totali I Kapitalit dhe I detyrimeve*** 2,600,500,505 2,296,370,619

**Pasqyra e te ardhurave individuale**

|                                                                | <b>CFO PHARMA<br/>31 Dhjetor 2017</b> | <b>BASHKIMI<br/>31 Dhjetor 2016</b> |
|----------------------------------------------------------------|---------------------------------------|-------------------------------------|
| Shitje neto                                                    | 4,152,476,958                         | 4,250,823,896                       |
| Te ardhura tjera                                               |                                       | -                                   |
|                                                                | <b>4,152,476,958</b>                  | <b>4,250,823,896</b>                |
| Shpenzime operacionale                                         | (3,880,456,927)                       | (4,030,299,483)                     |
| Kosto mallit(fat vlere 0)                                      |                                       | -                                   |
| Paga sigurime shoqerore dhe shendetesore                       | (83,337,857)                          | (85,396,477)                        |
| Amortizimi                                                     | (14,652,782)                          | (13,992,327)                        |
| Te tjera shpenzime                                             | (134,763,880)                         | (69,274,619)                        |
|                                                                | <b>-4,113,211,446</b>                 | <b>(4,198,962,906)</b>              |
| <b>Rezultati nga aktiviteti kryesor</b>                        | <b>39,265,512</b>                     | <b>51,860,990</b>                   |
| Shpenzime per interesa huaje                                   | (9,469,881)                           | (11,478,434)                        |
| Humbje nga diferenca konvertimi                                |                                       | -                                   |
| Te ardhura (shpenzime) financiare                              | 109,918,819                           | 27,565,795                          |
| <b>Shpenzime financiare- neto</b>                              | <b>100,448,938</b>                    | <b>16,087,361</b>                   |
| Fitimi përpara tatimit                                         | <b>139,714,450</b>                    | <b>67,948,351</b>                   |
| Shpenzime te pa zbritshme                                      |                                       | -                                   |
| Tatim fitimi                                                   | 20,957,168                            | 10,192,253                          |
|                                                                |                                       |                                     |
| <b>Fitimi (humbje) neto për periudhën</b>                      | <b>118,757,283</b>                    | <b>57,756,098</b>                   |
| Diferenca konvertimi nga operacionet jashtë njesisë            |                                       | -                                   |
| Rivlerësime të pasurive të paluajtshme                         |                                       | -                                   |
| Tatim mbi të ardhurat gjithëpërfshirëse                        |                                       | -                                   |
| <b>Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse (neto nga tatimi)</b> |                                       | -                                   |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën</b>   |                                       | -                                   |
|                                                                | <b>31 Dhjetor</b>                     | <b>Bashkimi 31</b>                  |
|                                                                | <b>2017</b>                           | <b>Dhjetor 2016</b>                 |
| <b>Fitim i atribuar për:</b>                                   |                                       | -                                   |
| Aksionerët e Shoqerisë                                         | 118,757,283                           | 57,756,098                          |
| Te tjera aksione në minorance                                  |                                       | -                                   |
| <b>Fitimi i periudhës</b>                                      | <b>118,757,283</b>                    | <b>57,756,098</b>                   |
|                                                                |                                       | -                                   |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse i atribuar për:</b> |                                       | -                                   |
| Aksionerët e Shoqerisë                                         | 118,757,283                           | 57,756,098                          |
| Te tjera aksione në minorance                                  |                                       | -                                   |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën</b>   | <b>118,757,283</b>                    | <b>57,756,098</b>                   |

## Pasqyra e Flukseve Monetare

| Pasqyra e fluksit monetar - Metoda direkte               | CFO PHARMA<br>2017   | Bashkimi 31<br>Dhjetor 2016 |
|----------------------------------------------------------|----------------------|-----------------------------|
| <b>Fluksi I parave nga veprimtarite e shfrytezimit</b>   |                      |                             |
| Parate e arketuara nga klientet                          | 4,102,517,424.8      | 3,323,968,101               |
| Parate e paguara ndaj furnitoreve dhe punonjesve         | (3,842,398,284)      | (3,195,661,602)             |
| Parate te ardhura/paguara nga veprimtarite               |                      | -                           |
| Interes I paguar                                         | (9,469,881)          | (11,478,434)                |
| Tatim mbi fitimin i paguar                               | -                    | -                           |
| <b>Shuma (Para neto nga veprimtarite e shfrytezimit)</b> | <b>250,649,260</b>   | <b>116,828,065</b>          |
| <b>Fluksi I parave nga veprimtarite investuese</b>       |                      |                             |
| Pagese per blerje te kompanive te kontrolluara           |                      |                             |
| Pagese per blerje e aktiveve aftagjata materiale         | (583,011,764)        | (200,134,922)               |
| Arketimet nga shitja e pajisjeve                         |                      |                             |
| Interes I arketuar                                       |                      |                             |
| Dividentet e Arketuar                                    |                      |                             |
| <b>Para neto te perdorura ne veprimtarite investuese</b> | <b>(583,011,764)</b> | <b>(200,134,922)</b>        |
| <b>Fluksi monetar nga aktivitetet financiare</b>         |                      |                             |
| Arketime nga emetimi I kapitalit aksionar                |                      |                             |
| Arketime nga huamarrje afatgjata                         | 348,255,115          | 149,922,400                 |
| Pagesat e detyrimeve te pagesave te qirave financiare    | (47,799,215)         | (69,916,843)                |
| Dividente te paguar                                      |                      |                             |
| <b>Paraja neto e perdorur ne veprimtarite</b>            | <b>300,455,900</b>   | <b>80,005,558</b>           |
| Pagesa te pacaktuara                                     |                      |                             |
| <b>Rritja / Renia neto e mjeteve monetare</b>            | <b>(31,906,603)</b>  | <b>(3,301,299)</b>          |
| <b>Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel</b>   | <b>46,563,191</b>    | <b>49,864,490</b>           |
| <b>Mjetet monetare ne fund te perudhes kontabel</b>      | <b>14,656,587</b>    | <b>46,563,191</b>           |

Kapitali aksionar qe i perket aksionareve te shoqerise meme

|                                            | Kapitali aksionar | Primi i aksionit | Aksio net e thesari t | Rezerva statutore dhe ligjore | Rezerva te konvertimit te monedhave te huaja | fitimi i pashperndare | Rezerva te tjera | Shuma te parashi kuara per rreziqe | Totali        |
|--------------------------------------------|-------------------|------------------|-----------------------|-------------------------------|----------------------------------------------|-----------------------|------------------|------------------------------------|---------------|
| Pozicioni me 31 Dhjetor 2016 CFO           | 918,000,000       | -                | -                     | 95,557,348                    | -                                            | 115,133,402           | -                | -                                  | 1,089,780,367 |
| Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel |                   |                  |                       |                               |                                              |                       |                  |                                    |               |
| Pozicioni i rregulluar                     | 918,000,000       | -                | -                     | 95,557,348                    | -                                            | 118,757,283           | -                | -                                  | 1,132,314,631 |
| Pozicioni i rregulluar                     | 677,000,000       |                  |                       |                               |                                              |                       |                  |                                    | 677,000,000   |
| Dividentet e paguar/deklaruar              |                   |                  |                       |                               |                                              | -                     |                  |                                    | -             |
| Transferime ne rezerven e detyr ligjore    |                   |                  |                       | -                             |                                              | -                     |                  |                                    | -             |
| Transferi ne rezerven e detyr statut       |                   |                  |                       |                               |                                              |                       |                  |                                    | -             |
| Transferime ne rezerva te tjera            |                   |                  |                       |                               |                                              |                       |                  |                                    | -             |
| Emetimi i kapitalit aksionar               |                   |                  |                       | -                             |                                              | -                     |                  |                                    | -             |
| Rezerva rivleresimi i AAGI                 |                   |                  |                       |                               |                                              |                       |                  |                                    | -             |
| Transferim ne detyrimet                    |                   |                  |                       |                               |                                              |                       |                  | -                                  | -             |
| Blerje aksionesh thesari                   |                   |                  |                       |                               |                                              |                       |                  |                                    | -             |
| Terheqje kapitali per zvogelim             | -                 |                  |                       |                               |                                              | -                     |                  |                                    | -             |
| Pozicioni me 31.12.2017                    | 1,595,000,000     | -                | -                     | 95,557,348                    | -                                            | 118,757,283           | -                | -                                  | 1,809,314,631 |



## **I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË.**

Shoqëria **“CFO PHARMA ” shpk**, është krijuar si person juridik prane Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tirane, me datë 05.11.2002, me kapital fillestar të nënshkruar në vlerën 100.000 leke. Kapitali aktual i shoqërisë është 1,372,185,000 leke, i zotëruara 100% nga ortakët e vetëm të shoqërisë Z. Nadir Çauholli.

**Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:** Import-eksport, ruajtje, shpërndarje, shitje me shumicë e pakicë të artikujve farmaceutik dhe parafarmaceutik, shtesave ushqimore dhe produkteve bimore, produkteve kozmetike, bimeve medicinale, barnave narkotike dhe psikotrope, pajisjesh mjeksore etj.

**Adresa:** Shoqëria i ka adresën e saj kryesore, Rruga Pavaresia, Ndertesa nr 1, Kashar, Tirane. Administrator i shoqërisë është Z.Nadir Çauholli.

## **II. BAZA E PREGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **a. Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe interpretimet e ligjit Nr 9228 datë 29 Prill 2004 “Mbi Kontabilitetin” dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) duke filluar nga periudha ushtrimore 2016.

### **b. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### **c. Ndryshime në politikën kontabel**

Shoqëria aplikon Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Implementimi për herë të parë të SNRF1 e detyron njësinë ekonomike të përdorë të njëjtat politika kontabël në bilancin e çeljes sipas SNRF-ve dhe për të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të saj, të parat sipas SNRF-ve. Këto politika kontabël duhet të jenë në përputhje me çdo SNRF që është në fuqi në datën e raportimit për pasqyrat financiare të saj, të parat sipas SNRF-ve.



**d. Monedha Funksionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat**

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e Shoqeria. Informacioni ne pasqyrat financiare eshte paraqitur ne Leke.

**e. Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të ketyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushtat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

**1. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile**

Politikat kryesore kontabel te zbatuara nga shoqeria jane te pershkruara ne vijim:

**a. Instrumentat Financiare**

Instrumentat financiarë jo-derivativë te shoqerise përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke te tjera, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.



### **i. Njohja fillestare dhe cregjistrimi**

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve siç përshkruhet në vijim. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Aktivet financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

### **ii. Njohja e metejshme**

#### **Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten me tej me koston e amortizuar pakesuar me humbjet nga zhvlerësimet.

### **b. Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra nuk skontojnë.

Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Shuma e provizionit llogaritet si



diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Kerkesat për arketim vleresohen me vlerën nominale minus humbjen nga zhvlerësimi. Ato nuk janë vlerësuar me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv për të llogaritur vlerën e interesit të paperfituar në pasqyrat financiare përderisa nuk ka efekte materiale të këtyre interesave në datën e mbylljes së bilancit.

#### **c. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nëse është materiale.

##### **i. Përcaktimi i Vlerës së Drejte**

Vlera e drejte e parase dhe e likuiditeteve, llogarive të arketueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabel të dhënë, për shkak të maturimit të tyre afatshkurter.

##### **ii. Të tjera**

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### **d. Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

#### **e. Inventari**

Inventaret regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Kostot e inventarit janë përlogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese. Gjendjet e Inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre mesatare të ponderuar, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis saj dhe vlerës neto të realizueshme: Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përlogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit, pa koston e përlogaritur të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.



## **2. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)**

### **i. Njohja dhe matja**

Aktivitet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivitet.

Kostoja e aktiveve të kualifikuara përfshin kostot e interesit të kryera gjatë periudhave të ndërtimit, nëse ka, bazuar në normen mesatare të maturimit të huadhenies.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afat-gjate materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

### **ii. Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### **iii. Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.



Amortizimi kalohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Normat vjetore te amortizimit te perdorura, bazuar ne Ligjin 8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar dhe Udhezimit te Ministrise se Financave No.5 date 30.01.2006 ne zbatim te tij jane si me poshte:

| Aktivet Afatgjata Materiale | Norma e amortizimit % |      | Metoda e Llogaritjes |
|-----------------------------|-----------------------|------|----------------------|
|                             | 2017                  | 2016 |                      |
| Makineri e paisje           | 20                    | 20   | Vlera e mbetur       |
| Mobilje orendi              | 20                    | 20   | Vlera e mbetur       |
| Pajisje informatike         | 25                    | 25   | Vlera e mbetur       |

### 3. Konvertimi i monedhave te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilin eshte kryer transaksioni.

Aktivet dhe pasivet monetare ne monedhe te huaj ne daten e mbylljes se bilancit jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne daten e mbylljes se periudhes ushtrimore. Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe ne huaj në datën e hartimit të bilancit jane si me poshte (ne LEK):

| Monedha | 31 Dhjetor 2017 | 31 Dhjetor 2016 |
|---------|-----------------|-----------------|
| 1 EUR   | 132.95          | 137.28          |
| 1 USD   | 111.1           | 125.79          |

### 4. Të ardhurat - Njohja

#### • Shitjet

Te ardhurat nga shitjet e mallrave regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne raport me perfundimin e realizimit te shitjes se mallit, ne daten e raportimit.

Te ardhurat qe lidhen me aktivitetin kryesor jane te deklaruar ne kohen e perfitimit te tyre.



- **Shpenzimet**

Shpenzimet janë njohur kur ka lindur ulja në përfitimet e ardhshme ekonomike që është e lidhur me një pakësim të një aktivi ose rritje të një detyrimi, e cila mund të matet me besueshmëri.

## **5. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marre parasysh metoden e interesit efektiv. Shpenzimet per interesa perfshijne interesin e pagueshem mbi borxhet e marra per qellime te kapitalit te punes, te perlllogaritur me metoden e normes efektive te interesit.

## **6. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit perbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe çfaredolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15%.

## **7. Rezultati Tatimor.**

Rezultati tatimor per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017 paraqitet si vijon:

| <b>Rezultati Tatimor</b>  | <b>Viti 2017</b>  | <b>Viti 2016</b>  |
|---------------------------|-------------------|-------------------|
| Rezultati Ushtrimor       | 139,714,450       | 67,948,351        |
| % e Tatim Fitimi          | 15%               | 15%               |
| <b>Tatimi mbi Fitimin</b> | <b>20,957,168</b> | <b>10,192,253</b> |

**AUDITUESE E PAVARUR**

**Shpresa BREÇANI**

**Lic. Nr. 143**

